



ODA EKONOMIKE E KOSOVËS KOSOVA CHAMBER OF COMMERCE

ODA EKONOMIKE - KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS OF COMMERCE  
NO: 404  
13.07.2018  
PRISHTINË

Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtinë - KOSOVË  
Tel: +381 (0) 38 224 741, Te&Fax: +381 (0) 38 224 299  
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

**RREGULLORE  
E PUNËS SË KUVENDIT TË  
ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS**

Prishtinë, Korrik 2018

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës dhe 22 paragrafit 1.1 pika 4 e Statutit të OEK-ut, Kuvendi i OEK-ut, miratoi këtë

## **RR E G U L L O R E** **PËR PUNEN E KUVENDIT TË ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS**

### **I. Dispozitat e përgjithshme**

#### Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Kuvendit të Odës Ekonomike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi i OEK-ut).

Rregullorja e Kuvendit të OEK-ut përmban dispozita mbi: të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarit në Kuvendin e OEK-ut, mbi verifikimin e zgjedhjes së anëtarëve, ecuria e punës në mbledhje të Kuvendit të OEK-ut, procedura e zgjedhjes së organeve dhe stafit udhëheqës OEK-ut, bashkëpunimi i Kuvendit të OEK-ut me njësitë rajonale të OEK-ut, bashkëpunimin e Kuvendit me organet qeverisëse dhe organizatat tjera joqeveritare si dhe bashkëpunimi me përfaqësuesit e mjeteve të informimit.

#### Neni 2

Përbërja, veprimtaria dhe autorizimet e Kuvendit të OEK-ut janë të përcaktuara me Ligjin dhe Statutin e OEK-ut.

#### Neni 3

Puna e Kuvendit të OEK-ut është publike.

### **II. Verifikimi i zgjedhjes së anëtarëve**

#### Neni 4

Verifikimin e zgjedhjes së anëtarëve të ri e bënë Kuvendi i OEK-ut në mbledhjen e parë pas zgjedhjeve.

Verifikimi bëhet sipas propozimit të Komisionit për zbatimin e zgjedhjeve të cilin e zgjedh Kuvendi i OEK-ut.

#### Neni 5

Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve, shqyrton raportin e Shoqatave dhe të Njësive Rajonale për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit, bënë certifikimin dhe revokimin e mandateve të anëtarëve dhe për gjendjen e konstatuar i raporton Kuvendit të OEK-ut.

#### Neni 6

Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve përbëhet prej Kryetarit dhe katër anëtarëve të zgjedhur nga radhët e anëtarëve të Kuvendit.

#### Neni 7

Kuvendi formon komisionin verifikues për verifikimin e kandidaturave për organet e OEK-ut, i cili komision përbëhet prej 7 anëtarëve të Kuvendit, 5 anëtarë me bazë deleguese nga Shoqatat Sektoriale dhe 2 anëtarë me bazë deleguese nga Njësitë Rajonale.

### **III. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve në Kuvendin e OEK-ut**

#### Neni 8

Anëtarët e Kuvendit të OEK-ut (në tekstin e mëtejshëm: anëtarë) janë të barabartë me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë-obligimet.

#### Neni 9

Anëtari në Kuvendin e OEK-ut, i shpreh dhe i mbron interesat e OEK-ut, Shoqatës Sektoriale – Njesisë Rajonale e cila e ka zgjedhur në Kuvendin e OEK-ut dhe së bashku me anëtarët e tjerë vendos dhe merr qëndrime lidhur me çështjet nga veprimtaria i Kuvendit të OEK-ut.

#### Neni 10

Anëtari i Kuvendit të OEK-ut, për punën e vet personalisht i përgjigjet Kuvendit të OEK-ut, përkatësisht kuvendeve të shoqatave dhe të njësive rajonale në të cilën është zgjedhur. Organet e ndërmarrjes - anëtare të OEK-ut, mundën që përmes Kuvendit të shoqatës-njesisë rajonale të revokojnë anëtarin e vet dhe të emërojnë anëtarë të ri në Kuvendin e OEK-ut.

Nëse anëtari, nuk i përmbahet udhëzimeve të Kuvendit të shoqatës-njesisë rajonale në të cilën është zgjedhur, Kuvendi i shoqatës-njesisë rajonale do ta informojë për këtë ndërmarrjen dhe mund të propozojë që të iniciohet procedura për revokimin e tij.

#### Neni 11

Anëtari ka për detyrë dhe obligim që të jetë prezent në mbledhjet e Kuvendit të OEK-ut dhe të marr pjesë në punën dhe marrjen e vendimeve.

Anëtari i cili është i penguar që të prezantohet në mbledhjen e Kuvendit të OEK-ut, ka për obligim që lidhur me këtë, ta lajmërojë Sekretarin e OEK-ut.

#### Neni 12

Anëtari ka të drejtë që të kërkojë sqarime dhe informata prej Këshillit Drejtues, Kryetarit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe organeve të tjera të OEK-ut, mbi çështjet të cilat bëjnë pjesë në veprimtarinë e tyre, si dhe të fillojë iniciimin e shqyrtimit të çështjeve nga veprimtaria e tyre.

#### Neni 13

Anëtari ka të drejtë të paraqesë amendamente në propozimin e akteve të përgjithshme të cilat i shqyrton dhe i nxjerr Kuvendi i OEK-ut.

Amendamenti, parimisht, paraqitet para fillimit të mbledhjes së Kuvendit të OEK-ut, e mund të paraqitet edhe në vetë mbledhjen e Kuvendit të OEK-ut.

#### Neni 14

Për një informim sa më të plotë, anëtarëve, pos materialeve që shqyrtohen dhe për të cilat vendoset në Kuvendin e OEK-ut, iu dërgohen edhe publikimet e rregullta dhe të kohëpaskohshme për punën e OEK-ut.

#### Neni 15

Me akt të përgjithshëm të OEK-ut, në mënyrë të posaçme, përcaktohen se cilat dokumente paraqesin sekretin e veprimtarisë, komunikimi i të cilave para personave të paautorizuar, për shkak të natyrës së tyre dhe rëndësisë, do të

ishite në kundërshtim me interesat e OEK-ut dhe anëtarëve të OEK-ut. Kryesuesi i Kuvendit të OEK-ut, në përputhje me aktin e përgjithshëm nga paragrafi 1 i këtij neni, gjatë dërgimit të materialeve anëtarëve, e përcakton cili material konsiderohet sekret i veprimtarisë ose i natyrës sekrete.

#### Neni 16

Anëtari përgjigjet për cenimin e detyrës së ruajtjes së sekretit të veprimtarisë dhe të dhënave të natyrës sekrete.

### **IV. Rendi i punës në Kuvendin e OEK-ut.**

#### **a).Thirrja e mbledhjeve.**

#### Neni 17

Kuvendi i Odës mbledhet më së paku 1 (një) herë në vit. Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të OEK-ut, e thërret Kryesuesi i Kuvendit të OEK-ut. Mbledhja e Kuvendit të OEK-ut, mund të thirret edhe me propozimin e Këshillit Drejtues të OEK-ut, njësisë rajonale dhe me propozimin e 2 shoqatave të OEK-ut si dhe nga ana e 1/5 së anëtarëve të Kuvendit të OEK-ut, duke parashtruar arsyet e thirrjes së mbledhjes. Kuvendin e OEK-ut, mund ta thërrasë edhe Kryetari i OEK-ut, nëse paraqitet nevoja për shqyrtimin e çështjeve të rëndësisë të veçantë për OEK-un apo çështjet e interesit shtetëror. Propozuesit të cilët kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes së Kuvendit të OEK-ut, e dorëzojnë materialin për çështjet për të cilat kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes. Nëse Kryesuesi i Kuvendit të OEK-ut nuk e thërret mbledhjen në afatin prej një muaj dite, nga dita e ushtrimit të kërkesës për thirrjen e mbledhjes, mbledhjen do ta thërrasin ushtruesit e propozimit.

#### Neni 18

Ftesa për mbledhjen e Kuvendit të OEK-ut me propozimin e rendit të ditës, doemos duhet t'iu dorëzohen anëtarëve më së voni shtatë (7) ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes. Pas ftesës për mbajtjen e mbledhjes, anëtarëve iu dorëzohet propozimi i rendit të ditës, me materiale gjegjëse të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen e Kuvendit të OEK-ut, si dhe procesverbali nga mbledhja e kaluar. Përyjashtimisht thirrja urgjente e mbledhjes së Kuvendit të OEK-ut, mund të bëhet edhe në afat më të shkurt se shtatë (7) ditë, e rendi i ditës për atë mbledhje mund të propozohet po në atë mbledhje. Në rastet kur Kuvendi i ri i Odës nuk arrin të konstituohet brenda afateve të parapara atëherë Sekretari i Përgjithshëm i Odës, mundet ti ftoj anëtarët e ri të Kuvendit në takimin Konstituiv, për kohën të cilën e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i Odës, apo Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve.

#### **b) Rendi i ditës së mbledhjes.**

#### Neni 19

Rendin e ditës së mbledhjes së Kuvendit të OEK-ut, e përgatit dhe e propozon Kryesuesi i Kuvendit të OEK-ut.

#### Neni 20

Gjatë përpilimit të rendit të ditës do të merren parasysh edhe iniciativat të cilat

vijnë nga shoqatat dhe njësitë rajonale të OEK-ut.

#### Neni 21

Rendin e ditës së mbledhjes së Kuvendit të OEK-ut e përcakton Kuvendi në fillim të mbledhjes.

### **c) Hapja e mbledhjes, kryesimi dhe pjesëmarrja në të.**

#### Neni 22

Seancën konstituive të Kuvendit të OEK-ut, deri në zgjedhjen e Kryesuesit të ri të Kuvendit të OEK-ut, e kryeson anëtari më i vjetër i Kuvendit nga përbërja e re e anëtarëve të Kuvendit.

Mbledhjen e Kuvendit të OEK-ut, e udhëheqë Kryesuesi i Kuvendit të Odës.

Kryesuesi e hap mbledhjen dhe i njofton të pranishmit për numrin e anëtarëve që janë prezent në të.

Nëse vërtetohet se në mbledhjen e Kuvendit nuk është prezent numri i mjaftueshëm i anëtarëve, mbledhja shtyhet.

Për prezencën e anëtarëve në mbledhje mbahet evidenca.

#### Neni 23

Pasi që ta hap mbledhjen Kryesuesi i Kuvendit jep sqarime të nevojshme lidhur me punën në mbledhje dhe për çështje tjera paraprake.

Kryesuesi i Kuvendit e informon Kuvendin për atë se kush është i ftuar në mbledhje dhe cilët anëtarë e kanë paralajmëruar mosardhjen tyre dhe e kanë arsyetuar mungesën.

#### Neni 24

Anëtarët e Këshillit Drejtues të OEK-ut, kanë të drejtë dhe obligim që të marrin pjesë në punën e Kuvendit të OEK-ut.

Në punën e mbledhjes së Kuvendit mund të marrin pjesë përfaqësues të shoqatave si dhe bashkëpunëtorët shkencor, profesional e publik të cilët në mbledhje janë të ftuar për dhënien e mendimeve lidhur me çështjet e caktuara, por nuk mund të marrin pjesë në marrjen e vendimeve.

#### Neni 25

Pas hapjes së mbledhjes së rregullt të Kuvendit, kalohet në propozimin e rendit të ditës. Çdo anëtarë ka të drejtë të propozojë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës së propozuar.

Kur anëtari propozon plotësimin e rendit të ditës, ka për detyrë që ta arsyetojë vënien e çështjes së propozuar në rendin e ditës, për të cilin deklarohet Kuvendi.

Para fillimit të punës, pas përcaktimit të rendit të ditës, kalohet në aprovimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

#### Neni 26

Në fillim të shqyrtimit të çdo pike të rendit të ditës, përfaqësuesi i ushtruesit të propozimit mund të jep sqarime plotësuese.

Anëtarët dhe pjesëmarrësit tjerë të Kuvendit marrin fjalën, sipas radhës së paraqitjes për të marrë fjalën.

Kur të vërtetohet se s'ka më diskutues të tjerë, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se diskutimi për atë çështje të rendit të ditës mori fund.

#### Neni 27

Askush nuk mund të flasë në seancën e Kuvendit, para se të kërkojë dhe të marrë fjalën nga Kryesuesi.

Kryesuesi, anëtarëve, iu jep fjalën sipas radhës së paraqitjes.

Diskutuesi mund të flasë për çështjen që është në rend të ditës. Nëse diskutuesi largohet nga çështja e cila është në shqyrtim e sipër, Kryesuesi i Kuvendit, do ta ftojë që ai t'i përmbahet rendit të ditës.

Koha e diskutimit të anëtarit dhe pjesëmarrësve tjerë në mbledhje nuk është e kufizuar, por Kuvendi mund të vendos që pjesëmarrësi, për të njëjtën çështje, mund të diskutojë vetëm njëherë, por mund të kufizohet edhe koha e diskutimit. Kryesuesi përkujdeset që pjesëmarrësi në mbledhje mos të jetë i penguar gjatë diskutimit.

#### Neni 28

Kryesuesi mund ta ndërpresë punën e Kuvendit gjatë mbledhjes dhe të caktoj ditën dhe orën kur ajo do të vazhdojë.

Kryesuesi e ndërpre në punën e Kuvendit: për shkak të mungesës së kuorunit, për shkak të tejkalimit të kohës, për shkak të pushimit të anëtarëve, kur paraqitet nevoja për të kryer konsultime dhe të jepen sqarime të nevojshme, si dhe në raste tjera kur për to vendos Kuvendi.

Nëse mbledhja është ndërprerë për shkak të mungesës së kuorunit, e kuorumi nuk ekziston as në vazhdimin e mbledhjes, pas kalimit të një ore, Kryesuesi i Kuvendit konstaton përfundimin e mbledhjes.

#### Neni 29

Nëse për çështjen e cila shqyrtohet nuk kërkohet nxjerrja e aktit ose nëse Kuvendi nuk dëshiron që për të, të vendos, Kuvendi përfundon shqyrtimin e asaj çështjeje dhe kalon në shqyrtimin e çështjes tjetër që është në rend të ditës.

Pasi që të jenë shqyrtuar të gjitha çështjet nga rendi i ditës, Kryesuesi e përfundon mbledhjen e Kuvendit të OEK-ut.

### **d) Marrja e vendimeve**

#### Neni 30

Kuvendi i OEK-ut mund të nxjerr vendime valide, nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të zgjedhur.

#### Neni 31

Për marrjen e vendimit, për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të OEK-ut, dhe për përcaktimin e kuotës së anëtarësisë në OEK, është e nevojshme pëlqimi i 2/3 të të gjithë numrit të anëtarëve të Kuvendit, e në raste të tjera Kuvendi nxjerr vendime me shumicën e votave.

#### Neni 32

Votimi në mbledhjet e Kuvendit të OEK-ut është publik, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe. Votimi bëhet me ngritjen e dorës ose duke e ftuar çdo anëtar veç e veç të deklarohet.

Anëtarët në Kuvend mund të votojnë "për" ose "kundër" propozimit përkatësisht çështjes për të cilën votohet, e mund edhe të abstenojnë.

Nëse shumica e anëtarëve përmbahet prej votimit, konsiderohet se çështja apo propozimi për të cilin është votuar, është refuzuar.

#### Neni 33

Pas përfundimit të votimit, Kryesuesi e konstaton dhe shpall rezultatin e votimit,

sipas të cilit propozimi, për të cilin është votuar, është aprovuar ose është refuzuar.

#### Neni 34

Anëtari i Kuvendit i cili nuk akordohet me vendimin e aprovuar, mund ta ndajë mendimin e vet dhe ka të drejtë që në procesverbal qëndrimin e vet ta formulojë.

### **e) Mbjajtja e rendit.**

#### Neni 35

Për mbajtjen e rendit gjatë mbledhjes së Kuvendit të OEK-ut përkujdeset Kryesuesi i Kuvendit.

#### Neni 36

Për prishjen e rendit në mbledhje të Kuvendit, mund të shqiptohen këto masa: vërejtje, marrja e fjalës dhe largimi nga mbledhja. Nëse Kryesuesi me masa të ndërmarra nuk mund ta mbajë rendin në mbledhjen e Kuvendit, atëherë do ta ndërpresë mbledhjen.

### **ë). Procesverbali**

#### Neni 37

Për punën e mbledhjes së Kuvendit të OEK-ut mbahet procesverbali. Për caktimin e procesmbajtësit kujdeset Sekretari i Përgjithshëm i OEK-ut.

#### Neni 38

Procesverbali duhet të përmbajë: numrin rendor të mbledhjes, datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes, numrin i anëtarëve prezent dhe emrat e anëtarëve që mungojnë si dhe emrat e personave të tjerë të ftuar që marrin pjesë në punën e mbledhjes, rendin e ditës së mbledhjes, emrat e pjesëmarrësve në diskutim për çështje të caktuara të rendit të ditës, konkluzat, rekomandimet dhe aktet e tjera me tekst të plotë dhe formë të përcaktuar si dhe mendimet e ndara të anëtarit rreth çështjeve për të cilat është vendosur në mbledhje.

Kryesuesi mund të caktoj që në procesverbal të shënohen edhe të dhëna të tjera nga mbledhja.

Procesverbalin e nënshkruan Kryesuesi i Kuvendit të OEK-ut.

#### Neni 39

Aktet që i miraton Kuvendi i OEK-ut i nënshkruan Kryesuesi i Kuvendit të OEK-ut.

Vendimet, konkluzat dhe rekomandimet nga mbledhja e Kuvendit të OEK-ut publikohen në mjetet e informimit të OEK-ut.

#### Neni 40

Për hartimin e procesverbalit, formulimin e vendimeve të aprovuara si dhe akteve tjera dhe publikimin e të njëjtave, përkujdeset Sekretari i Përgjithshëm i OEK-ut.

## **V. Procedura e zgjedhjes dhe revokimit të organeve dhe stafit udhëheqës të OEK-ut**

### **Neni 41**

Kuvendi i OEK-ut emëron Komisionin për Zbatimin e Zgjedhjeve për kandidatë për zgjedhjen e Kryetarit të OEK-ut.

Komisioni zgjedhor i merr parasysh të gjitha kandidaturat e paraqitura nga anëtarët e Kuvendit, bën certifikimin apo revokimin e mandateve të kandidatëve dhe i propozon Kuvendit listën e kandidatëve anëtarë të Kuvendit për Kryetar të OEK-ut.

### **Neni 42**

Kryetari i OEK-ut zgjidhet kandidati i cili fiton numrin më të madh të votave të anëtarëve të Kuvendit.

### **Neni 43**

Kryetari i OEK-ut, pas zgjedhjes, paraqet propozimet për zgjedhjen e organeve të tjera të OEK-ut, anëtarëve të Këshillit Drejtues, Sekretarit të Përgjithshëm, Kryesuesit të Tribunalit të Arbitrazhit, dhe Kryesuesin e Këshillit të Nderit-Gjykatës së Nderit.

### **Neni 44**

Zgjedhja e stafit udhëheqës dhe anëtarëve të tjerë nga neni 43, i kësaj Rregulloreje, kryhet me votim publik, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe.

### **Neni 45**

Nëse Kuvendi i OEK-ut, vendos që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë, Kuvendi e zgjedhë Komisionin Zgjedhor teknik prej 7 anëtarëve i cili do ta kryejë punën rreth votimit dhe konstatimit të rezultateve të votimit.

Rezultatet e votimit të fshehtë, publikohen në Kuvend nga ana e raportuesit të Komisionit Zgjedhor.

### **Neni 46**

Kur me Ligj apo Statut të OEK-ut është paraparë, se për organet e caktuara nuk bëhet zgjedhja e anëtarëve të atyre organeve, por atë e përbëjnë personat e caktuar sipas pozitës së tyre, pas konstituimit të atyre organeve, Kryetari i OEK-ut do ta njoftojë Kuvendin për përbërjen e organeve dhe personave të cilët janë anëtarë të atij organi.

### **Neni 47**

Kuvendi i OEK-ut mund të revokoj nga detyra Këshillin Drejtues ose disa anëtar të tij, Kryetarin, nënkryetarët e OEK-ut, Sekretarin e Përgjithshëm të OEK-ut si dhe organet tjera të OEK-ut, të cilët ai i zgjedh apo i emëron, nëse :

- ✓ Nga Gjykata e Nderit konstatohet se nuk kanë zbatuar vendimet e Kuvendit apo Këshillit Drejtues të Odës;
- ✓ Nëse nga Gjykata e Nderit konstatohet se nuk i përmbahen dispozitave të akteve të Odës, në veçanti Statutit të Odës;
- ✓ Nëse Gjykata e Nderit konstaton se është dënuar për ndonjë vepër penale apo të kriminalitetit ekonomik;
- ✓ Nëse Gjykata e Nderit konstaton se është angazhuar në ndonjë post të partie politike,
- ✓ Nëse Gjykata e Nderit konstaton se Komisioni për mandate i Kuvendit të OEK-ut u ka revokuar mandatin zgjedhor, dhe
- ✓ Sipas kërkesës së tyre.

## **VI. Bashkëpunimi i Kuvendit të OEK-ut me**



## organet dhe organizatat tjera në Kosovë

Neni 48

Kuvendi i OEK-ut realizon bashkëpunimin e vet me Parlamentin e Kosovës, Qeverinë dhe me organet e tjera qeverisëse në Kosovë, partitë politike duke siguruar pjesëmarrjen e tyre në shqyrtimin e çështjeve nga veprimtaria e Kuvendit të OEK-ut dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të atyre organizatave në punën e mbledhjeve të Kuvendit.

Për atë qëllim, në mbledhjet e Kuvendit, ftohen përfaqësuesit e atyre organeve dhe organizatave, për ti paraqitur mendimet dhe propozimet e veta lidhur me çështjet që shqyrtohen në mbledhjet e Kuvendit të OEK-ut e të cilat janë me interes të përbashkët.

## VII. Bashkëpunimi me mjetet e informimit

Neni 49

Përfaqësuesve të shtypit dhe mjeteve tjera të informimit, iu krijohen kushtet dhe iu lihen në disponim propozimet e akteve të cilat shqyrtohen në Kuvendin e OEK-ut, materiali informativ dhe dokumentacioni për çështjet që shqyrtohen në mbledhjet e Kuvendit të OEK-ut, përpos nëse Kuvendi ka vendosur që çështjet e caktuara të shqyrtohen pa prezencën e përfaqësuesve të shtypit dhe mjeteve tjera të informimit.

Për bashkëpunim me përfaqësuesit e shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit, përkujdeset Sekretari i Përgjithshëm i OEK-ut.

## VIII. Dispozitat kalimtare.

Neni 50

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën kur ta aprovojë Kuvendi i OEK-ut.

Neni 51

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi punën e Kuvendit të OEK-ut, e nxjerr në janar të vitit 2006.

## KUVENDI I ODËS EKONOMIKE TE KOSOVES

Prishtinë, 11.07.2018

KRYESUESI I KUVENDIT TË ODËS  
z. Ruzhdi Kurtishaj

